

DREJTËSIA

DITARI MUJOR

PLANI I RITJES SË PAGAVE 2023-2024 PËR PUNONJËSIT E SIGURISË



LEXO PËR MË SHUMË

Ministri Manja bashkë me Kryeministrin Edi Rama dhe Ministrin e Brendshëm Bledi Çuçi, në takim të përbashkët të Policisë së Rendit dhe asaj të Burgjeve, për rritjen e pagave. Pas disa reformave të ndërmarra gjatë vitit 2022 vazhdon rritja e pagave për stafin e Policisë së Burgjeve.

PRIORITETET E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT PËR VITIN 2023



Në Prokurorinë e Përgjithshme, në praninë e Prokurorit të Përgjithshëm z. Çela si mikpritës dhe Drejtuesin e SPAK z.Dumani, Ministri Manja prezantoi para drejtuesve të prokurorisë së juridiksionit të përgjithshëm prioritetet e Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023, si detyrim që buron nga Kushtetuta dhe neni 103/3 i ligjit nr.97/1016 "Për organizimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë." Katër janë shtyllat ku duhet të fokusohet puna e prokurorisë për vitin 2023: -Garantimi i pavarësisë funksionale të prokurorëve në ushtrimin e ndjekjes penale dhe hetimin e veprave penale; -Lufta kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar; -Respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut; -Bashkëpunimi me EuroJust dhe me prokuroritë homologe në luftën kundër krimin të organizuar transnacional. Brenda këtyre drejtimeve kryesore për vitin 2023, theksi duhet të vihet tek: -Ashpërsimi i politikës së dënimit për krimin e dhunës në familje sidomos për përsëritësit në krim - Në funksion të këtij objekti si Ministër i Drejtësisë i kam propozuar Këshillit të Ministrave e më pas votimin në Kuvendin e Shqipërisë një ndryshim në Kodin e Procedurës Penale që autorët e krimin në familje të mos përfitojnë nga gjykimi i shkurtuar; -Krimin kibernetik -Krimin zgjedhor, meqë ky vit është dhe viti që do mbahen zgjedhjet vendore. Manja shprehu që sukcesi i luftës kundër kriminalitetit dhe realizimi i prioritetëve të Këshillit të Ministrave për vitin 2023 do arrihet vetëm nëse të gjithë së bashku mbështesim njëri-tjetrin dhe bëjmë detyrat që na ngarkon Kushtetuta dhe ligji. **LEXO PËR MË SHUMË**

MANJA TAKON PRESIDENTIN E UNIONIT NDËRKOMBËTAR TË NOTERËVE Z. LIONEL GAILLEZ



Z.Gaillez ka një kontribut thelbësor në forcimin e notariatit botëror dhe do të ndajë me Ministrinë e Drejtësisë dhe Dhomën Kombëtare të Noterëve gjithë përvojën e tij dhe të Unionit për fuqizimin e shërbimit noterial shqiptar për tu bërë konkures në tregun rajonal dhe ndërkombëtar! Manja i siguroi z.Gaillez se Ministria e Drejtësisë dhe Dhoma Kombëtare e Noterëve do të jenë partnerë të besueshëm në këtë bashkëpunim me interes reciprok për të mirën e qytetarëve shqiptarë! **LEXO PËR MË SHUMË**

KONGRESI I TRETË I NOTARIATIT SHQIPTAR



Në kongres u diskutua për të ardhmen e notariatit në Shqipëri dhe adresimin e sfidave që janë përpara. Në kushtet e një bote që po ndryshon me shpejtësi për shkak të teknologjisë dhe digjitalizimit, lëvizjes së lirë të njerëzve, tregjeve dhe kapitaleve, shërbimi noterial shqiptar do të duhet të përballet me sfidat e kohës për tu bërë garante e zbatimit të ligjit dhe e mbrojtjes së interesit publik. Profesionalizmi dhe digjitalizimi janë pasaportë e sigurtë për një shërbim noterial me integritet që gëzon besueshmërinë e publikut. Një shërbim noterial që gëzon besimin e publikut meriton transferim më të madh kompetencash nga shteti tek noterët, por notariatit shqiptar i duhet shumë punë për ta merituar këtë besim. Notariati shqiptar ka filluar të përballet me sfidat e kohës, është në hapat e parë të konsolidimit dhe modernizimit dhe në këtë rrugëtim do ketë gjithë mbështetjen e Ministrisë së Drejtësisë si monitoruese e drejtpërdrejtë e veprimtarisë së saj!

TAKIM ME SEKRETARIN E PËRGJITHSHËM TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË Z.GENC GJONÇAJ



Manja takon në Ministrinë e Drejtësisë me Sekretarin e Përgjithshëm të Kuvendit të Shqipërisë, mikun e bashkëpunëtorin e tij të kahershëm Genc Gjonçaj. Arsyeja e këtij takimi ishte për të cuar përpara punën për Edukimin ligjor, e-law digjitalizimin e akteve. Roli udhëheqës i Kuvendit në një Republikë Parlamentare si Shqipëria, mbetet kyç në realizimin e reformave në fushën e shtetit të së drejtës dhe sundimit të ligjit. **LEXO PËR MË SHUMË**

IEVP DURRËS - TAKIM PËR ANALIZËN E PUNËS 3-MUJORE



Menaxhimi, siguria, disiplina dhe respektimi i të drejtave të të dënuarve dhe paraburgosurve duke zbatuar me rigorozitet ligjin dhe rregulloren e përgjithshme të burgjeve, është vija e kuqe për të gjithë zinxhirin drejtues, punonjësit e policisë dhe stafin në këtë IEVP.

QPKMR - TAKIMET PËR FUQIZIMIN E KAPACITETEVE DHE SHKËMBIMIN E PËRVOJAVE PËR TRAJTIMIN E RASTEVE TË TË MITURVE DHE TË RINJVE NË KONFLIKT ME LIGJIN



LEXO PËR MË SHUMË

QPKMR vazhdon takimet për fuqizimin e kapaciteteve dhe shkëmbimin e përvojave për trajtimin e rasteve të të miturve dhe të rinjve në konflikt me ligjin. Takimi u zhvillua me Znj. Sylvie Le Blavec, e ngarkuar me misionin pranë Shkollës Kombëtare për Mbrojtjen Gjyqësore të të Rinjve dhe Znj. Mariem ES-SAIDI, trajnuese në polin territorial të trajnimeve të "Grand Nord" pranë Shkollës Kombëtare për Mbrojtjen Gjyqësore të të Rinjve në Francë. Bashkëpunimi me misionin francez në drejtësinë për të mitur vazhdon të forcohet me plane bashkëpunimi konkrete dhe shkëmbime përvojash shumë të dobishme.

TRAJNIM 2 DITOR ME TEMË "NDËRVEPRIMI NDËRINSTITUCIONAL, ROLI I PUNONJËSIT SOCIAL DHE PSIKOLOGUT NË REHABILITIMIN E TË MITURVE DHE TË RINJVE NË KONFLIKT ME LIGJIN"



LEXO PËR MË SHUMË

Është përmbyllur me sukses trajnimi 2 ditor me temë "Ndërveprimi ndërinstytucional, roli i punonjësit social dhe psikologut në rehabilitimin e të miturve dhe të rinjve në konflikt me ligjin". Në fokus të këtij trajnimi ishte bashkëpunimi ndërinstytucional mes stafit të Qendrës së Parandalimit të të Miturve dhe të Rinjve si dhe i Institutit të të miturve Kavajë. Në mbyllje të këtij aktiviteti u falenderuan Znj Anila Dollani dhe Z.Ditmire Lita që dhanë kontributin dhe ekspertizën e tyre në ndihmë të dy stafëve.